



NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Balkan Finance Investment Group, BALFIN Group, është një nga grupet më të suksesshme të investimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Aktivitetet e Grupit Balfin përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të paluajtshme, biznesin retail, banking-un, industrinë minerare, turizmin, energjitikën, logjistikën, etj,

TIRANA BANK, një nga bankat kryesore në Shqipëri dhe anëtare e Balfin Group, mirëpret kandidatë dinamik të cilëve iu pëlqen marrëdhënia me klientët për t'iu bashkuar **Degës së Shijakut** në pozicionin:

Përkufizimi i pozicionit:

Arkëtari ofron shërbim ndaj klientit për transaksionet cash dhe jo-cash, numëron, kontrollon dhe kuadron fondet monetare në degë në përputhje me procedurat dhe rregulloret në fuqi.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Vepron në përputhshmëri me procedurat dhe rregulloret në fuqi të bankës dhe direktivave të Rregullatorit lidhur me transaksionet e arkës;
- Njeh dhe zbaton me përpikmëri të gjitha procedurat operacionale të lidhura me rolin e tij/saj.
- Kryen veprime cash dhe jo cash në menyrë të saktë të sigurt e të shpejtë duke siguruar një shërbim cilësor për klienti;
- Eshtë përgjegjës për zbatimin e procedurave të limitit të Cash-it;
- Referon klientë tek oficerët përkatës të kredisë respektivisht retail ose individë referuar nevojës së identifikuar të klienti;
- Përgjegjës për arritjen e targetit individual;
- Mbulon transaksionet si më poshtë:
 1. Depozitime
 2. Tërheqje
 3. Transfera nga njëra llogari në tjetrën
 4. Pagesa utilitetesh
 5. Pagesa tek të tretët
 6. Exchange cash
 7. Ceqe
 8. Veprime për ATM
- Rregjistron në sistem klientë rastësorë duke i hedhur të dhënat me saktësi dhe korrektësi dhe merr formularët përkatës;
- Siguron që klientëve t'u shërbehet pa vonesa për të arritur standardet e vendosura nga Banka

Kompetencat / aftësitë e kërkuara:

- Diplomë universitare në Ekonomi ose fushë të ngjashme;
- Aftësi shumë të mira komunikuese dhe negociuese;
- Të jetë fleksibël, të ketë shpirtin e skuadrës dhe aftësi të punojë nën presion ;
- Aftësi shumë të mira prezantuese;
- Njohuri shumë të mira shkruese dhe verbale të gjuhës angleze;
- Njohuri shumë të mira të programeve Microsoft Office;

Kandidatët e interesuar mund të dërgojnë një **CV** brenda datës **10 shkurt 2021** në adresën elektronike të Burimeve Njerëzore: recruitment.hr@tiranabank.al duke specifikuar pozicionin për të cilin aplikojnë.

Ju lutem kini prarasysht që vetëm personat që plotësojnë kriteret e sipërpërmendura do të kontaktohen.

Të dhënat tuaja personale, të cilat dergohen nga ju vullnetarisht si përgjigje ndaj kësaj shpallje për vend të lirë pune, mblidhen dhe përpunohen, manualisht dhe/ose elektronikisht, nga Banka Tirana sha, me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë tuaj për t'u punësuar në këtë vend pune, aksesohen vetëm nga persona të autorizuar të Bankës dhe do të ruhen deri në përfundim të procesit të përzgjedhjes së kandidatit fitues. Subjektet e të dhënave personale, mund të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, pranë Bankës Tirana sha, si dhe pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale